



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



---

**ZYRA E PROJEKTEVE**  
BIRO ZA PROJEKTE – PROJECT OFFICE

---



# **RAPORT** *janar – dhjetor 2013*

*Raporti perfshin bashk punimin me :*

- *Organizata Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare*
- *Qeverinë e Republikës së Kosovës*
- *Drejtorit Komunale*
- *Komunitetin Lokal – praticipimet në projekte*
- *Shoqerin Civile - organizatat dhe shoqatat e ndryshme*
- *Të tjera*

*Për informata më të plota rrethë raporteve dhe të dhenave tjera të Zyrës së projekteve mundë të klikoni edhe në web faqen : <http://kk.rks-gov.net/gjilan/>,  
linku : projektet – investimet kapitale dhe linku : pasqyrat dhe planet komunale*

*Ju falemderojm për mirëkuptim,*

*Fadil Osmani, Menaxher i zyrës së projekteve  
E-mail : [fadilosmani02@yahoo.com](mailto:fadilosmani02@yahoo.com)*

*Dhjetor ' 2013*

*Hyreje :*

---

Zyra e projekteve në Gjilan ka një mision të veçantë dhe të profesionalizuar për të shërbyer për qytetarët e Gjilanit dhe për të realizuar kërkesat, nevojat dhe propozimet e tyre.

Krahas këtij misioni Zyra e Projekteve do të ishte e pamundur ta kryente këtë mision pa bashkëpunimin e mirë, të sinqertë dhe të gjithanshëm me të gjithë mekanizmat relevantë ndërkombëtar.

Zyra e Projekteve është e fuqishme kur ajo ngritë nivelin e bashkëpunimit me Organizatat Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare, gjë që ne e kemi bërë me përkushtimin më të madh dhe më të mirë të mundshëm.

Tashmë Zyra e Projekteve ka ndërtuar ura bashkëpunimi me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe të gjitha Ministrit e saja. Qeveria e Kosovës është mbështetëse e shumë projekteve për komunën e Gjilanit dhe ne kemi qenë gjithmonë të hapur dhe në dispozicion të të gjithë digasterëve qeveritarë.

Gjithashtu Zyra e Projekteve është e hapur me të gjitha Drejtorit komunale dhe Komunitetin Lokal . Përmes drejtorive komunale dhe përmes grupeve qytetare duke përfshirë këtu edhe formën e participimit, Zyra e Projekteve ka qenë në shërbim të tyre duke ofruar të dhëna të mjaftueshme infrastrukurore dhe materiale të nevojshme për të nisur çfarëdo projekti.

Zyra e Projekteve ka një afërsi dhe një kordinim të mirë edhe me shoqërinë civile dhe OJQ e regjistruara në Gjilan. Me të gjitha OJQ-të kemi raporte bashkëpunimi dhe marrim pjesë në të gjitha zhvillimet e tyre që janë në interes të jetës shoqërore, politike, ekonomike, sociale kulturore të Gjilanit.

Zyra e Projekteve rëndësi të madhe i kushton edhe bashkëpunimit me mediet lokale me të cilat kemi një raport shumë profesional. Mediet pasqyrojnë rregullisht punën tonë dhe mbi këtë bazë ne mundohemi të jemi transparentë duke njoftuar mediet për të gjitha projektet zhvillimore në Gjilan.

Me respekt

Fadil Osmani, menaxher në zyrën e projekteve



## European Bank for Reconstruction and Development

Rruga Prishtinë - Fushë Kosovë  
PO Box 122, 10060 Pristina Kosovo

Në takim i cili u mbajti gjatë muajit shkurt me përfaqësues të BERZH-it ku u paraqiten problemet e shumta të Komunës së Gjilanit sidomos ato në infrastrukture publike (ujësjellës, kanalizim dhe trajtim të ujrave të zeza) e cila pas dy javë rezultoi edhe organizimin e videokonferencës me përfaqësuesit e BERZH-it ku morën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe KRUK "Hidromorava".

Zyra e projekteve përgaditi shkresën e cila konfirmon BERZH-in se: Komuna e Gjilanit është e interesuar për fuqizimin e marrëdhënjeve mes Komunës së Gjilanit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky bashkëpunim do të ketë për qëllim realizimin e projekteve me prioritet të lartë të cilat ndikojnë direkt në përmirësimin e jetës së qytetarëve....

Kosova në dhjetor 2012 u bë anëtare e 66 e BERZH, e cila ka mbështetur sektorin e saj privat që nga viti 1999.



Programi përfshinë 7 komuna të Kosovës i cili financohet nga WBIF me 2.5 mil € dhe KfW (Bankën Gjermane për Zhvillim) 2.5 mil €. Në takim i cili u mbajti gjatë muajit shkurt u diskutua se deri në Qershor pritet të lidhen marrëveshjet e bashkëpunimit mes palëve të interesit, ndërsa realizimi (ekzekutimi) i projekteve pritet të fillojë në vitin 2014, viti 2013 do jetë vit i përgatitjes së projekteve dhe analizave tjera KfW do të jetë në mbështetje të vazhdueshme të Komunave.

Projektet do të financohen përmes kredive afatgjata 15 vite (duke përfshirë 5 vite grejs periudhën) të gjitha kontratat lidhen mes komunave Ministrisë së Financave dhe WBIF dhe KfW, Ministria e Financave është garantues e këtij procesi.

WBIF dhe KfW (Bankën Gjermane për Zhvillim) që është: (German Development Cooperation) mjetet jepen përmes formës së kredise e cila është 4% kamatë vjetore.

Zyra e projekteve përgaditi shkresën e cila konfirmon se Komuna e Gjilanit shprehë gadishmerin për vazhdimin e këtij komunikimi me programin e lartepërmendur dhe do të fillojë takimet edhe me grupet politike dhe Ministrinë e Financave.



Falë donacioneve të Qeverisë Daneze – organizates Qeveritare “DANIDA” gjatë vitit 2013 po e përfundon ndërtimin e objektit të shkollës së bujqësisë “Arbëria” .

Gjatë vitit 2012 zyra e projekteve ka përgatiturë projektin dhe i ka dorëzuar DANIDAs projektin : Ndërtimi i shtalles për mbajtne lopëve, pikën e përpunimit të mishit dhe qumështit dhe piken e grumbullimit të pemve dhe perimeve - gjatë muajit korrik projekti është në fazën e tenderit .

Në mars të vitit 2013 projekti : Ndërtimi i stallës se lopëve dhe objekteve përcjellëse si dhe depos ftohëse për peme dhe perime është kontraktuar në vleren 104,305.98 €, punë të cilat do të ekzekutohen nga kompania n.n.p “Inxhinjering” nga Ferizaji (te gjitha procedurate prokurimit deri në kontraktim janë kryer nga donatori)

Viti i ri shkollor 2013/2014 i Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe teknologjisë, “Arbëria”, në Gjilan, ka filluar në objektin e ri, ku në përrurimin e shkollës bujqësore donacion i DANID-ës Daneze dhe Komunës së Gjilanit ka folur Ramë Buja, Qemajl Mustafa e Bujar Nevzati....



**ProCredit Bank**

Pro Credit Bank i ka dhuruar gjatë muajit shtatorë 30 kompjuterë Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe teknologjisë, “Arbëria”, në Gjilan, mbështetje kjo që është mirëpritur nga drejtues të shkollës. Bekim Musliu, në emër të Pro Credit Bank, ka thënë se nga një numër kërkesa që kanë pasur, në rast kanë vendosur që ta ndihmojnë Shkollën e Mesme të Agrobiznesit dhe teknologjisë, “Arbëria”, ky donacion ka kompletuar me kompjuterë edhe kabinetin e lëndës së Teknologjisë Informative, ku krahas pjesës teorike, nxënësit e shkollë sonë do të mund të marrin dije edhe në aspektin praktik ....



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

**DEMOCRATIC EFFECTIVE MUNICIPALITIES INITIATIVE  
INICIATIVA PËR KOMUNA DEMOKRATIKE DHE EFEKTIVE  
INICIJATIVA ZA DEMOKRATSKE I EFEKTIVNE OPŠTINE**

Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (IKDE) / Democratic Effective Municipalities Initiative (DEMI) të USAID-it në Komunën e Gjilanit ka realizuar keto projekte :

- Emri i projektit : Furnizimi me software Traffic-ware sim sraffic 8 synchro-plus

---

- Numri i kontratës : EPP – 1-00-04-00036-00

---

- Vlera e participimit të programit USAID/DEMI : 4,515.68 ( pa TVSH)

---

- Vlera e participimit të Komunës së Gjilanit : 1,268.92 ( me TVSH)

---

Organizmin e Punëtorisë për stafin menaxherial të komunës së Gjilanit - Programi për Menaxhimin e Performancës (PMP), data 7 dhe 8 shkurt, 2013

- Emri i projektit : Nxjerrja e te dhenave vektoriale, kadastrale për shenjëzimin e parcelave komunale

---

- Numri i kontratës : EPP – 1-00-04-00036-00 – TO nr. 04

---

- Vlera e participimit të programit USAID/DEMI : 2,150.12 ( pa TVSH)

---

- Vlera e participimit të Komunës së Gjilanit : 1,268.92 ( me TVSH)

---

Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (IKDE) / Democratic Effective Municipalities Initiative (DEMI) të USAID-it në Komunën e Gjilanit me datë 8 gusht ka përfunduar programin .

Programi EU-KOSVET : Zyra e projekteve ka aplikuar në Qendren Regjionale të Punësimit në Gjilan – konkretisht në Programin Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian që implementon programin : “Zhvillimi i Shkathtësive për Ndërmarrësi dhe Krijimi i Ndërmarrjeve të Reja” , BE-KOSVET VI, i cili është themeluar në Kosovë që nga tetori 2009, është i dizajnuar të ndihmojë punëkërkuarët e rinj,

BE-KOSVET VI ka dy aktivitete kryesore :

- ofron “trajnimin në punë”, për të rinjtë e papunë mundësinë për të mësuar aftësitë profesionale të vlefshme gjatë punës në “kompaninë nikoqire”,
- ofrimi i trajnimit Ndërmarrësia dhe krijimi e ndërmarrjes së re të cilët dëshirojnë të themelojnë bizneset e tyre.

Projekti është duke punuar ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Qendren Regjionale të Punësimit në Gjilan) në fazën e parë janë duke e kryerë praktiken (3 mujore) nëpër drejtori dhe zyra komunale në këtë përbërje :

- Arta Bajrami , Drejtorja e Buxhetit dhe Financave
- Fatime Januzi, Drejtorja e Arsimit
- Lulzana Pajaziti, Zyra e informimit
- Adelina Morina, Instituciuonet Parashkollore
- Zylfije Ramadani, Zyra e projekteve
- Arbresha Ismajli, Zyra ligjore

Programi UNDP : Zyrtarë e projekteve aplikojnë në Qendren Regjionale të Punësimit në Gjilan – konkretisht në Programin e Kombëve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP ) që implementohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) programi : Programi i Gjenerimit të Punësimit - krijimi i vendeve të punës Asistencës për Praktikant

Në fazën e parë janë duke e kryerë praktiken (6 Mujore) nëpër drejtori dhe zyra komunale në këtë përbërje :

- Bleta Leka , Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik

Programi EU-KOSVET dhe UNDP i cili realizohet përmes Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Qendren Regjionale të Punësimit në Gjilan) e bene pagesen simbolike per keta praktikante ne vleren 100 €

*sqarim:*

*Programi EU-KOSVET i cili financohet nga Programet e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, i është bërë kërkesë nga Zyra e projekteve që programi të zgjatet për praktikant nga tre (3) muaj në gjashtë (6) muaj, kërkesa jonë është aprovuar në parim dhe presim që nga fillimi i vitit 2014 edhe të realizohet si i tillë .*



Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Komunën e Gjilanit ka realizuar këto projekte :

1. **Ndërtimi i Bibliotekes Rajonale**, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian shpallë tenderin në web faqen : [www.delprn.ec.europa.eu](http://www.delprn.ec.europa.eu) , me numer te references European Aid/130900/C/WKS/KOS, projekti ka filluar te realizohet gjate fillimit të muajit nëntor 2011, nga kompania AIBes – Istog, projekti pritet te përfundoj ne fillim te vitit 2013 .

Gjate vitit 2012 (shtator) projekti Ndërtimi i Bibliotekes Rajonale ndërprehet per shkakun e problemeve mes donatorit dhe punekryeist, ku jan majte disa takime me gjitha nuk eshte arrite te tejkalohen keto probleme .

Ne fillim te muajti prill te 2013 me insistim te zyres se projekteve organizohet takimi ne Zyren e Komisionit Evropian ku marrin pjese edhe perfaqesues te komunave (pasi jane ne nje pako te tenderimit) : Podujeva, Mitrovica, Obliqi, Fushë Kosova, Vushtrria , ne takim eshte diskutuar mbi rrejdhen e punimeve nga kjo kompani .

Gjate fundit te muajit prill Zyra e Komisionit Evropian merre vedim te largoj nga punishtet ne te gjitha komunat e lartepmendura kompanin “Albes” dhe te filloj me procedurat e ritenderimit te ketyre projekteve te cilat pritet te perfundojne deri ne shtatore ndersa sipas dimanikes se përcaktuar nga Komisioni Evropian keto projekte pritet te perfundojne ne tetore te vitit 2014.

2. **Ndërtimi i fushës së futbollit (stadionit ndihmës) mbi palestrën e sporteve – Gjilan, qëllimi i projektit** eshte krijimi i hapësirave për ekipet e futbollit të regjistruara zyrtarisht në Federatën e Futbollit të Kosovës , projekti eshte aprovuar gjate muajit dhjetor 2011. Gjatë vitit 2012 eshte tenderuar projekti në fjalë – gjatë muajit gusht është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit për fillimin e punimeve, gjatë muajit shtator / tetor fillon ekzekutimi i punimeve ne teren e cila eshte kontraktuar nga kompania “Hidroterm”nga Suhareka, projekti pritet të përfundoj gjatë vitit 2014.

Në fillim te muajti maj pritet te filloj ekzekutimi i këtij projekti i cili eshe financim i Zyres se Komisionit Evropian .

3. **Ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Bajram Curri” në fshatin Shurdhan**

Zyra e Komisionit Evropian ka publikuar tenderin i cili ka këto karakteristika :

- Publication reference EuropeAid/132396/C/WKS/XK,
- Procedure, Open : 7/11/2013,
- Programme :Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA),
- Financing Budget line – IPA 2010, IPA 2011 and IPA 2012

Me datë 18/09/2013 Zyra e Komisionit Evropian në bashkëpunim me Zyrën e projektve ka organizuar viziten në teren ku kanë mar pjesë Autoriteti kontraktues (Zyra e Komisionit Evropian) dhe kompanit e interesuara për pjesëmarrje në tender . Tani projekti eshte ne fazene tenderimit dhe pritet qe gjate vitit 2014 te realizohet projekti me qellim qe viti i ri shkollor 2014/2015 të filloj mësimet objektin e ri shkollor .

Projektet e organizates CDI mbeshteten financiarisht nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Projektet e organizates CDI mbeshteten financiarisht nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), pasi komisioni ne perberje Komune (zyra e projekteve dhe drejtoria e sherbiemve publike) dhe CDI ka identifikuar problemet e infrastruktures ne komunën tonë CDI ka aprovuar në parim realizimin e ketyre projekteve :

- Bresalcë dhe Ponesh - Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit
- Pogradjë - Rregullimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimit e impiantit per trajtimin e ujërave të zeza
- Zhegovcë - Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit

Me 2 dhjetor 2011, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim për projektin “Programi i Mbështetjes së Ujit dhe Sanitacionit në zonat rurale, faza IV” që do të implementohet në Kosovën Juglindore. Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe drejtori i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovës, Markus Baechler, ndërsa parasheh që Programi i Mbështetjes së Ujit dhe Sanitacionit në zonat rurale të financohet me 2 milionë e 250 mijë CHF nga Qeveria Zvicerane dhe 940 mijë euro nga Qeveria e Kosovës.

Me datën 06/08/2012 kryetari i komunës z. Qemajl Mustafa ka nënshkruar marrëveshjen me CDI zvicerane për rregullimin e projektit të ujësjellësit në Ponesh e Bresalc dhe rregullimin e kolektorit në Pogradjë në vlerë të 1 milion eurove, ku janë të përfshira tri fshatra Poneshi, Bresalci dhe Pograxha ne kete shume të mjeteve participojnë CDI-së, 45%, Komunës 35 % dhe Qeverisë 25 %. Realizimi i ketyre projekteve do të fillojë këtë vit ndërsa do të përfundojnë nga fundi i vitit 2013 .

Gjatë muajit shtatorë 2012 ka filluar procedura e tenderimit e cila është kryer nga CDI, në bazë të procedurave dhe ligjeve në fuqi të Prokurimit Publike për projektin :

- Bresalcë dhe Ponesh - Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit, vlera e kontratës 490,267.00€, punëkryesë “Teuta M” Gjilan
- Pogradjë - Rregullimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimit e impiantit per trajtimin e ujërave të zeza, vlera e kontratës 57,000 €, punëkryesë “Kushtrimi M” Viti
- Zhegovcë - Rregullimi i rrjetit kryesor të ujësjellësit, punëkryesë “Teuta M” Gjilan

Në mars të viti 2013 fillon realizimi i ketyre projekteve, fillimisht fillohet me fshatin Pogradjë, ndërsa në maj fillohet dhe me realizimin e projektit në fshatin Bresalc dhe Ponesh ku pritet të përfundojnë gjatë vitit 2014 , për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe disa problemeve pronsore juridike gjatë shpuarjeve të puseve dhe ndërtimit të rezervareve .

Gjatë vitit 2012 Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me organizten SECO (State Secretariat for Economic Affairs of the Swiss Government) e cila programin e ka implementuar nga kompania Holinger AG (SWISS), kane bere Hulumtimet gjeologjik dhe gjeo-mekanik i troallit ku do të ndërtohet rezervari i ujit, kjo pjese e projektit infrastruktura deri te rezervari eshte mbuluar nga mjetet finaciare të buxheti komunal, keti elaborati i ka parapri Vendi i Kuvendit ti dates 29.06.2012 i cili ka eliminuar problemet pronore judridike ne lakacionin e rezevarit në Kodren e Dëshmoreve .

Pas kryerjes së elaboratit gjeologjik dhe gjeo-mekanik i troallit (rezervarit) në dhjetor të vitit 2012 behet perzgjedhja e komanisë punëkryese të punimve e cila është kompania Fela Planungs AG ku eshte duke e bere ekzekutimin e puneve ne teren pjese e projektit : Furnizmi me ujë në Kosovën Juglindore e cila menaxhohet nga Komiteti Drejtues ne perberje Qeveria e Kosoves (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ndermarrjet Publike të Ujësjellësit “Hidromorava” Gjilan dhe “Bifurkacioni” Ferizaj, Drejtorja e Sherbimeve Publike)

Në muajin mars 2013 fillon realizimi i projektit në teren, komponenta investive e projektit permbane : tenderimin, kontraktimin, implementimin dhe kompletimin e Rezervarit me kapacitet të përgjithëshëm 3 000 m<sup>3</sup> , Gypa për kyçeje në rrejtin ekzistuese, De-aktivizim i rezervarit ekzistuese, pastaj ngritja kapaciteteve (fuqizimi i kapaciteteve për operim dhe projektim të rezervarit)



## PROGRAMI PËR TË DREJTAT CIVILE NË KOSOVË CIVIL RIGHTS PROGRAM KOSOVO – CRP/K

Zyra për projekte ka pasë një bashkëpunim të mirë me organizaten CRPK/K , më 17 tetor 2011, si e drejta për azil në Kosovë është përfshirë në sistemin ligjor dhe ka filluar të zbatohet nga viti 2008, dhe duke pasur parasysh edhe mungesën e traditës institucionale në trajtimin e kësaj të drejte, dhe angazhimin e institucioneve publike për trajtimin me sfida në zbatimin e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara (UNHCR) në Kosovë, në kuadër të projektit të zbatuar nga Programi për të Drejtat Civile-Kosovë (CRP/K) .

Programi për të Drejtat Civile-Kosovë (CRP/K) ka trajtuar rastet e komuniteteve jo shumice (serbe dhe rom) dhe ka mundësuar integrimin dhe pajisjen e tyre me dokumentacion valid .

Për më shumë informata rrethë : Programit për të Drejtat Civile-Kosovë (CRP/K) vizito web faqen : <http://www.crpkosovo.org>

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe drejtori i Fondacionit Ndërkombëtar “Balkan Net”, Jean Stanoevski me seli në Shkup, kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim mes dy administratave të Gjilanit dhe asaj të projektit Balkan Net “Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe eficientë e energjisë në Evropën Juglindore”.

Studimi do të bëhet për të mbledhur të dhënat për gjendjen e kërkesës për ngrohje për ekonomitë familjare, objektet komunale, bizneset dhe të tjera, gjendjen e konsumit të energjisë, për ekonominë familjare, komunën dhe bizneset .

Duke ju falënderuar këtij bashkëpunimi ka realizuar një projekt mbi auditivin energjetike të objektit të ish ekzekutivit po ashtu janë grumbulluar dhe prezantuar të dhëna mbi shpenzimet e energjisë në objekte komunale duke përfshirë edhe shkollat dhe ambulancat .

Po ashtu këto të dhëna janë prezantuar dhe dërguar edhe në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik – Agjencisë për Eficientë të Energjisë, po ashtu gjatë kësaj periudhe janë shkëmbyer edhe përvoja të shumta në aspektin e eficientës së energjisë me komunat e rajonit si : Shkodra (Shqipëri), Veles ( Maqedoni), Kakanjë (Bosna dhe Hercegovina) dhe Panqev (Serbi)



Qeveria Gjermane (German Cooperation për mes organizatave qeveritare GIZ ka implementuar projektin : Regional Marketing Initiative in Eastern and Southern Regions of Kosovo / Iniciativa e marketingut rajonal në rajonin lindor dhe jugor të Kosovës, projekti është implementuar nga RDA zyrë në Gjilan dhe Prizren në bashkëpunim me GLV (Grupet Lokale të Veprimt) të Regjionit Lindje.

Gjatë aktiviteteve të shumta është nxjerre edhe moto e Regjionit Lindje – Bukuria dhe dielli vijë nga Lindja (The beauty and the sun come from the East) po ashtu janë përgatitur dhe shtypur kataloge të këtyre profileve :

- a) Pasaporta rajonale
- b) Udhtimi nëpër foto
- c) Trashgimia kulturore
- d) Libri i me receta të ushqimeve tradicionale
- e) Paketa turistike

AZHR - Lindje është themeluar në dhjetor të vitit 2008 në partneritet në mes të komunave të Gjilan, Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçanik, Novobërde, Shterpce, Kamenice dhe Viti të cilat veprojë dhe funksionojë si koordinator dhe drejtues i aktiviteteve zhvillimore në rajonin ekonomik lindje dhe komunat e saj. Dy komuna të reja, Kllokoti dhe Ranillugu, kanë bashkuar procesin dhe janë bërë partnere të plota më 9 shkurt 2010 dhe në 10 Tetor komuna e Parteshit u bashkua djithashtu.

AZHR-Lindje do t'a kryej këto punë sipas kontratës me Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Si shtese e Zyres së BE-së do të ofroje fonde nga skema e granteve për projektet e zhvillimit rajonal të perkrahura dhe koordinuara nga AZHR-Lindje



Embassy of the Czech Republic  
in Pristina



Viti 2012 : Gjatë muajit korrik ne takime me Ambasaden Çeke e kemi ngriture qeshtjine e zones ekonomike e cila përfshin një hapësirë prej 69 hektarësh, që gjendet në një kënd të rëndësishëm të komunikimit rrugor dhe është një mundësi e mirë për ata që duan të investojnë, jo vetëm nga komunat Gjilan e Artanë, por edhe nga komunat tjera të regjionit të lindjes.

Zyra e projekteve ka përgatitur shkresen – kërkesen dhe projektin ideor (aplikacioni) si dhe ka aplikuar në Amasaden Çeke për financim të projektit fizibilitetit të zones ekonomike ne fshatin Llabjan .

Viti 2013 : premtimi i dhënë nga ambasada e Çekisë se do të angazhohet që në Institucionet e shtetit të tyre, të sigurojnë financimin e këtij studimi të fizibiliteti është realizuar, gjat muajit maj Komunës së Gjilanit i është konfirmuar se CzechInvent është zgjedhur si kompani për të bërë këtë studim dhe në fillim të qershorit ekspert nga Çekia do të fillojnë aktivitetet e tyre në Gjilan dhe Novobërdë .

Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me komunën e Novobërdës kohë kanë krijuar ekipin punues për përsheptimin e ndërtimit të Zonës Ekonomike Rajonale në komunën e Novobërdës në fshatin Llabjan. Studimin e fizibilitetit për këtë zonë ekonomike rajonale eshte domosdoshmëri për të plotësuar kushtet dhe kriteret për të licencuar zonën në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Gjatë muajit qershor nje delegacioni i komunave kosovare (Gjilan, Artanë e Lipjan) vizituan zonat e biznesit në Çeki, delegacioni në Ceki ka vizituar nje inkubator modern te biznesit ne Prage dhe eshte njoftuar me principet e investimeve, te themelimit dhe te funksionimit te tij. Fjala eshte per investime shumemilioneshe te cilat themeluesit qe jane OJQ te ndryshme i kane terhequr nga BE dhe nga qeveria Ceke dhe bankat. Pastaj eshte vazhduar me vizite ne dy qytete jashte Prages (Pardobice dhe ne Chrudim) ku eshte njoftuar detajisht me menyren e percaktimit per zonat e tyre industriale dhe menyren e menagjimit te tokes dhe te vete zones.

Ne presim që deri në fund të këtij viti zona ekonomike rajonale Gjilan/Novobërdë të licencohet në MTI dhe të fillohen investimet në infrastrukturën e kësaj zone të rëndësishme për regjionin tonë, pasi studimi i fizibilitetit hape rruge ketyre investimve . Projekti i studimit të fizibilitetit për zonën ekonomike që parashihet të ndërtohet në Artanë në një hapësirë prej 72 hektarësh ka përfunduar dhe ai është prezantuar në Gjilan me datë 18/10/2013 nga Kompania e specializuar çeke “CzechInvent” , në këtë prezantim kanë marrë pjesë kryetarë të komunave , përfaqësues të MTI, ambasadës çeke, UBT , AZHRL dhe partnerë tjerë strategjik që kanë dhënë kontribut për të arritur deri tek studimi final.

Projekti i studimit të fizibilitetit për zonën ekonomike që parashihet të ndërtohet në Artan (Novobërdë)ë në një hapësirë prej 72 hektarësh ka pasur keto karakteristika sipas marrëveshjes së datës 25/07/2013 :

Emri i projektit : Përgatitja e studimit të fizibilitetit për krijimin e zonës ekonomike të Llabjanit – Komuna e Novobërdës  
Implementimi : CzechINVENT & Quality Kosova

Investitor :

- a) Ministria e Punëve të Jashtëme e Republikës Çeke – 25.000 €
- b) Komuna e Gjilanit – 5.000 € dhe
- c) Komuna e Novobërdës : 1.250 €

Në prezantimin e fizibilitetit të zonës ekonomike të realizuar nga partnerët strategjik të Komunës së Gjilanit dhe Artanës, “CzechInvent” dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) u tha se rajoni i Anamoravës me krijimin dhe funksionalizimin e zonës ekonomike do të fuqizohet edhe më shumë ekonomikisht.



Komuna e Gjilanit dhe Organizata Ndërkombëtare UNDP gjatë vitit 2013 përmes organizatës lokale Innovation Centre Kosovo kanë realizuar projektin Mediat Sociale për Fuqizimin Inovativ Lokal ku janë krijuar ura lidhëse mes qeverisë së nivelit lokal dhe njerëzve të rinj duke shfrytëzuar potencialin e platformave të medie sociale dhe teknologjisë mobile.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë zhvilluar disa aktivitete gjegjësisht projekte të vogla si : Organizimi i trajnimit të punëtorëve komunal në menaxhimi i rrjeteve sociale ,organizimi i konferencës „Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen komunale“, pastaj lansimi i video dokumentarit nga kampanja “Pyt...?”, animacioni “ku po shkojë paratë tona” dhe aktivitetet të shumta nga të cilat disa janë organizuar nga OJQ lokale në Komunën e Gjilanit si OJQ “ Ec ma ndryshe” pastaj programi “Merr pjesë” në kooperim me OJQ “KCIC”.



Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit dhe bashkëpunimin me projektin Cultural Heritage Without Borders (CHWB) - Trashëgimia Kulturore pa Kufi e cila bënë implementimin e programit “Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturore 2012-2015” pjesë e së cilës është Komuna e Gjilanit .

Duke pasur parasysh se progresi i arritur ka nevojë për një dinamik edhe më të madhe, po ashtu duke parë se ekziston vullneti i mirë i bashkëpunimit në këtë drejtim, palët e poshtëshënuara janë dakorduar dhe kanë arritur të realizojnë gjatë vitit 2014 projektin :

- Ndërtimi i urës afër Kalasë së fshatit Pogragjë ,
- Qëllimi i projektit : Rregullimi i urës për qasje të vizitoreve në Kalanë e Pogragjës

Projekti do të bashkëfinancohet nga Organizatës Suedeze Cultural Heritage Without Borders (CHWB) financon projektin në shumën prej : 70.000.00, Komuna e Gjilanit financon këtë projekt në shumën prej : 37,810.00 €, Projekti “Ndërtimi i urës afër Kalasë së fshatit Pogragjë “ – ura mbi lumin Morava ka vlerën paralogaritë prej :107,810.00 €

Projekti ideor Ndërtimi i urës afër Kalasë së fshatit Pogragjë është përgatiturë nga kompania N.N.SH “B Plan” Prishtinë, që është financuar nga Cultural Heritage Without Borders, ndërsa projekti kryesor është në hartim e sipër dhe do të financohet nga Komuna e Gjilanit .



Komuna e Gjilanit kanë një fuqi të madhe të kapitalit njerëzor që jeton diasporë, diaspora ka luajtur rol qenësor përgjatë historisë më të re të Kosovës dhe ajo vazhdon të jetë një prej potencialeve më të mëdha të zhvillimit të Kosovës.

Projekti DEED (Diaspora Engagement in Economic Development) është iniciativa inovative që i mundëson Diasporës së Kosovës të luajë një rol aktiv dhe efektiv si agjent i zhvillimit në bashkësitë prej nga vijnë ata.

Projekti DEED (Përfshirja e Diaspores në Zhvillim Ekonomik) financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës dhe zbatohet bashkërisht me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) misioni në Kosovë.

Projekti DEED (Diaspora Engagement in Economic Development) ka mundësuar dhe financuar një vizitë studimore ku përfaqësuesit e komunave Gjilan, Novobërdë, Suharekë, Skenderaj, Vushtri dhe ata na Ministria për Tregti dhe Industri po qëndrojnë në një vizitë studimore në Turqi. (Ankara, Stamboll dhe Bursa).

Përfaqësues të komunave Gjilan dhe Novobërdë kanë promovuar zonën ekonomike Gjilan - Novobërdë para afaristëve nga Turqia, ku një pjesë e tyre janë me prejardhje nga Kosova dhe emocionalisht janë të lidhurë për Kosovën, ne po krijojmë mundësi që një pjesë e këtyre emocioneve, të përvojës dhe investimeve të barten tek ne .

Gjatë fundit të muajit dhjetor 2013, Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ua ka shpërndarë certifikatat përfituesve të granteve, në vlerë prej 16 mijë eurove grante dhe 16 mijë euro kontribut nga familjet që jetojnë në diasporë. Nga ky projekt kanë përfituar këta persona: Ismete Zymberi – Gjilan, Albina Arifi- Rexhepi- Gjilan, Sami Syla – Gjilan, Feime Rexhepaj – Kamenicë, Qëndrim Lubishani – Viti, Zvonimir Vasic – Partesh, Radomir dhe Jasmin Zhivkonic – Partesh dhe Nagovan Jovanovic nga Parteshi. Ky projekt është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës dhe e përkrahur nga UNDP.

## Caritas Luxembourg



Caritasi i Luxemburgut përmes strategjisë “ Zbutja e varfërisë përmes Zhvillimit të Qëndrushëm 2011/2013, programi financohet nga Qeveria e Luxemburgut ka aprovuar projektin me bashkëfinancim me komunën në fshatin Kishnapole e cila me datën 12/12/11 është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit mes paleve .

Komuna e Gjilanit është e përzgjedhur për një investim në vlerë mbi 400 mijë euro, ku komuna e Gjilanit merr pjesë me 30 % të vlerës së përgjithshme në këtë projekt ndërsa pjesën tjetër prej 70% e mbulon “Caritasi”, investimet do të bëhen në tri sfera, në edukim, në shëndetësi dhe sektori tjetër është gjenerimi i të hyrave që do të punohet në komunitete. Synojmë të përmirësojmë jetën e këtyre banorëve në sferat e përmendura dhe përveç këtyre i kemi edhe tri tema transversale siç janë përmirësimi i barazisë gjinore, parandalimi i konfliktit dhe mbrojtja e ambientit .

Tabela : obligimet e sipas marrëveshjes e mirëkuptimit :

Sektori	Caritasi i Luxemburgut	Komuna e Gjilanit
Arsimi	123,500.00	37,050.00
Shëndetësi	53,225.00	15,967.50
Gjerimi i të ardhurave	99,145.00	29,743.50

Ambienti	21,800.00	Sipas nevojave
Gjinia	4,675.00	Sipas nevojave
Paranalim konflikti	10,375.00	Sipas nevojave
Punëtoritë	3,739.75	1,121.93
Gjithësjetë	316,459.75	83,882.93
<b>Totali € (vitet 2011/2013)</b>		<b>400,342.68</b>

Gjate vitit 2012/2013 jemi të angazhuar që të realizojm projektin :

o Ndërtimi i objektit të ri të shkollës fillore “Afërdita” në fshatin Kishnapole Komunal i Gjilanit (Drejtoria e Arsimit dhe Zyra e projekteve) ka koordinuar te gjitha veprimet me organizaten e Caritasit të Luxemburgut, po ashtu veprimet jane koordinuar edhe me Ministrin e Arsimit për nevojen e participimit në këtë projekt .

Zyra e projekteve ka kompletuar edhe elaboratin gjeomekanik të lokacionit të shkolles fillore “Afërdita” Kishnapole e cila i ka hape rruge procesit tekrijimit te Marreveshjes se Mirekuptimit per bashkefinacimit te këtij projekti ku eshte nënshkruar ne maujin maj 2013 .

Sipas Marreveshjes se Mirekuptimit te nënshkruar nga palet : Caritasi i Luxemburgu Ministrisë së Arsimit dhe Komuna e Gjilanit, palët kanë marë obligimet e tyre financiare :

Caritasi i Luxemburgut : 118,692.31 € ose 32,49%

Ministria e Arsimit : 211,000.00 € ose 57.76 %

Komuna e Gjilanit : 35,607.69 ose 9.75 %

Tenderi ka këto karatristika :

Data e shpalljes : 22 korrik 2013

Numri i references : FCL 13 012 RED – EDU - KISH

Data e vizites ne teren : 30/07/2013, ora 10.30

Data e mbylljes : 05/08/2013, ora 13.30

Kontraktor : N.P. “Krap Com”, nga Prishtina

Vlera e përgjithshme e projektit : 346,202.56 €



Komuna e Gjilanit është mirënjohëse për bashkëpunimin ne mes Komunës se Gjilanit dhe UN Habitat-it për plotësimin e komponentës së Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, respektivisht komponentës se Vlerësimit dhe Menaxhimit te Fatkeqësive dhe Rrezikshmërisë, dhe identifikimit të projekteve për bashkëfinancim.

Gjatë fillimit të muajit gusht të viti 2013, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka prezantuar të premtën para qytetarëve projektin për trajtimin e rrugëve “Adem Jashari” e “Zija Shemsiu”, të hartuar në bashkëpunim me ekipet e UN HABITAT-it, këto dy rrugë shtrihen në një gjatësi prej mbi 900 metrave, nga xhamia e madhe e deri te Fakulteti i Edukimit ( tani Univerisiteti „ Kadri Zeka „ Gjilan

Zyra e projekteve përmesë detyres projektuese dhënë byros projektuese ka përgatitur projektin dhe ju ka dorzuar UN HABITAT-it për financimë gjatë muajit qershor 2013, projekti përfshin infrastrukturën nëntokësore, që nënkupton rretin elektrik, telekomunikacionin, ujësjellësin dhe kanalizimin, rregullimin e trotuaret, gjelbërimin ...



An EU funded project  
managed by the European  
Union Office in Kosovo

DEVELOPMENT  
ACADEMY

Implemented by  
RIINVEST Institute



Në një ceremoni solemne, me pjesëmarrjen e zyrtarëve të lartë të Kuvendit dhe Qeverisë, përfaqësuesve të Bashkimit Evropian në Kosovë, kryetarëve të komunave dhe të mysafirëve tjerë të rëndësishëm, është bërë përrurimi i Akademisë Zhvillimore si produkt kryesor i projektit që financohet nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe implementuar nga Instituti Riinvest.

Qëllimi kryesor i këtij projekti të titulluar "Fuqizimi i kapaciteteve të zhvillimit ekonomik rajonal të Kosovës, përmes Akademisë Zhvillimore, njësive komunale për zhvillim dhe menaxhim të projekteve si dhe implementimit të projekteve me ndikim të shpejtë" është të konsolidojë dhe fuqizojë kapacitetet e regjioneve për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik rajonal dhe të përgjithshëm të Kosovës. Në kuadër të aktiviteteve të Akademisë Zhvillimore do të organizohen ligjërata në 2 cikle me kohëzgjatje secili prej 3 muajve, e ku për pjesëmarrësit do të zhvillohen 24 ligjërata intensive. Klasa e parë e pjesëmarrësve do të fillojë ndjekjen e ligjëratave në muajin qershor, me pritje për diplomim në fund të këtij viti.

Nga ky projekt do të përfitojnë të gjitha komunat e Kosovës, bizneset dhe shoqëria civile. Në programet trajnuese të akademisë për çdo cikël do të përfshihen si vijues rreth 50 zyrtarë komunal dhe përfaqësues të shoqatave të bizneseve. Synimi i programeve trajnuese që do të zhvillohen në këtë akademi është zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të akterëve rajonal për të aplikuar, menaxhuar dhe implementuar projekte zhvillimore të financuara nga donatorë të ndryshëm, me theks të veçantë projekte të financuar nga zyra e BE-së.



*Bashkëpunimi Ndërkufitar* është instrument i financuar nga BE dhe i ko-financuar nga shtetet bashkëpunuese, që përkrah dhe mundëson shtetet kufitare të bashkëpunojnë në fushën e p.sh. ekonomisë, shoqërore, të mjedisit, kulturore dhe aktiviteteve sportive. Kosova momentalisht është e përfshirë në bashkëpunim ndërkufitar me fqinjët e saj maqedonas, shqiptar dhe malazezë. Bashkëpunimi Ndërkufitar implementohet përmes *projekteve*, të cilat financohen përmes *granteve që ju dhurohen* organizatave jo-profitabile që përzgjidhen. Komuna e Gjilanit ka siguruar zyrën dhe paisjet tjera të nevojshme për zyrat e programit BNK-së e cila punon në kuadër të zyrave të RDAsë, aktualisht jemi duke e prite thirrjen për propozime .

Thirrja për projekt propozime është shpalluar me numër të referencës : **EuropeAid /135-229/LACT/MK**, afati i fundit për aplikim është **20 janr 2013** , në këtë program Komuna e Gjilanit ka inkurajuar Komunat e Regionit Lindje dhe shoqërinë civile si partnere në këtë program deri me tani ka kërkuar të aplikojmë vetëm organizata REA me seli në Prishtinë

Informata shtesë : Zona e gjithëmbarshme e shtrirjes së programit në Kosovë dhe në iRJM përbëhet nga pjesa thelbësore përfituese pjesa periferike shtesë (vetëm në Kosovë). Cili do projekt BNK i cili zhvillohet në kuadër të programit BNK, duhet me pas së paku një partner projekti nga çdo anë e kufirit të zonave përfituese . Si shtesë, një partner tjetër mund të vijë nga zona shtesë (në këtë rast, kjo vlen vetëm për Kosovë) dhe vetëm një maksimum deri 20% mund të shpenzohet për projektin në zonë shtesë. Zona programuese e BNK-së në Kosovë mbulon: Rajonin lindor ekonomik (zona përfituese), duke i përfshirë komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novo Bërdës, Ferizajt, Kaçanikut, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit.

Pjesa kosovare e zonës së programimit mbulon 6.537 km<sup>2</sup> me popullatë të përgjithshme prej rreth 1.703.610 qytetarëve (78% të popullatës së gjithëmbarshe të Kosovës). Zonat përfituese dhe zonat shtesë përbëhen prej 20 komunave dhe 821 vendbanimeve (fshatrave).



Programi II (EU- CSP II) është projektuar për të adresuar nevojat e pakicave për të gjeneruar të ardhura dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Kjo është bërë përmes ofrimit të asistencës financiare dhe teknike, Programi II (EU- CSP II) financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (për me shume informata : [www.eucspkosovo.org](http://www.eucspkosovo.org) )

Zyra e projekteve ka bashkëpunuar ngushtë me këtë program dhe ka arritur realizmin e këtij projekti :

Emri i projektit : Ri-konstruktimi i fushës së sportit në fshatin Shillovë

---

Vlera e projektit : € 34,779.20

---

Kontributi i programit Kontributi i BE-CSP II : € 29,193.00

---

Kontributi i Komunës së Gjilanit : € 5,586.20

---

Implementues i projektit : nnp “ Arhiko.ing”

Te gjitha procedurat e prokurimit ( shpallja, vlersimi dhe kontraktimi) janë kryer nga Programi II (EU- CSP II) .



Zyra e EU në Kosovë gjatë muajit nëntor ka lancuar raundin e katër (4) të skemës së granteve të EURED, thirrja e programit EURED permbane keto te dhena : (EU **Regional Economic Development grant scheme**, Numri i Reference : **EuropeAid/135-174/L/ACT/XK** ) , afati i fundit për aplikim ka qen 19 janari 2013, përshkak të procesit zgjedhore eshte shtyrë afati për aplikim deri më 28 janar 2014 , ne kete program Komuna e Gjilanit ka inkurajuar Komunat e Regjionit Lindje si partnere në këtë program, biznest private dhe shoqërin civile për aplikim .

Objekti i thirrjes është zhvillimi ekonomik rajonal, konkretishtë kontribuojë në konsolidimin e rajoneve ekonomike në përputhje me praktikrat më të mira të BEsë, krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin ekonomik rajonal



Gjatë vitit 2013 zyra e projekteve ka qenë e angazhuar në realizimin e projektit “zhvillimi i turizmit në regjionin lindje”, projekt i financuar nga Bashkimi European i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë dhe implementuar nga Komunitet e Regjionit Lindje .

Aktivitetet e këtij projekti kanë identifikimi i zonave turistike në Regjionin Lindje, pjesë e aktiviteteve është edhe vendosja e panove (billbordave) ku paraqiten zonat e turizmit në Regjionin Lindje (moto : Enjoy the colors of East Region – Shijoni ngjyrat e Regjionit Lindje) po ashtu në fund të këtij programi është mbajtur festivali i ushqimit dhe pijeve të organizuar nga projekti

Festivali ka për qëllim prezantimin e ofertave të ushqimit pijeve dhe produkteve artizanale në regjion duke vlersuar si segment të rëndësishme në zhvillimit të ofertës turistike.

Realizimi i këtij projekti ka kontribuar në zhvillimin regjional ekonomik të Regjionit Lindje të Kosovës përmes zhvillimit dhe promovimit të objekteve turistike po ashtu edhe përmes promovimit të produkteve lokale tradicionale bujqësore si dhe produkteve artizanale duke krijuar ndërlidhje me potencialet aktuale turistike si dhe përmes sinergjisë në mes të objekteve turistike në regjion

*Sqarim:*

*Bashkimi European ka qenë pjesë integrale e përpjekjeve ndërkombëtare për ndërtimin e një të ardhmeje të re për Kosovën që nga viti 1999, Bashkimi European – shtetet anëtare dhe institucionet e tij, veçanërisht Komisioni European – luan një rol të rëndësishëm në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës.*

*Bashkimi European është donatori më i madh që ofron ndihmë për Kosovën dhe rajonin e Evropës Juglindore në tërësi dhe udhëheq përpjekjet e rindërtimit.*

*Bashkimi European është prezent në Kosovë përmes : Zyrës ndërlidhëse të Komisionit European në Kosovë, Përfaqësuesit Special të Bashkimit European (EUSR), EULEX dhe Përfaqësive të shteteve anëtare të BE (Ambasadave dhe Zyrave ndërlidhëse)*

Zyra e projekteve ka përgatitur të gjitha paramasat për projektet (terenet sportive) të cilat projekte janë shpallur në dy lote që përfshin këto lokalitete :

Lot I : *Ndërtimi i terreneve sportive*

- fshati Llashticë

- Fshati Uglarë dhe

- Fshatin Livoq i Ulët

- Fshati Velekincë,

- Fshati Cërrnicë (vetem rrethojat e terenit)

Lot II : *Ndërtimi i terreneve sportive :*

- Fshati Livoq i Epërm

- Fshati Ponesh

- Fshati Myhyr

- Fshati Kmetovc

- Fshati Bresalcë

Shenime :

Emri i projektit : ndertimi i terreneve sportive ( lot I dhe lot II)

Data e publikimit te tenderit : 22/08/2013

Data e planifikuar e nënshkrimit te kontrates : 02/09/2013

Tenderi nr:

Nr. i prokurimit	Gi 651	1	3	0	8	2	5	2	1
------------------	--------	---	---	---	---	---	---	---	---

Lot I : *vlera e kontraktuar € : 109,931.71*

Emri i kontraktorit : *shpk " Magjistranja " Gjilan*

Lot II : *vlera e kontraktuar € : 112,264.59*

Emri i kontraktorit : *shpk "EL\_BAU & CONEKS GROUP" Gjilan*

Zyra e projekteve ka përgatitur të gjitha paramasat edhe për këto projekte :

- Tereni sportive dhe rrethojat e shkolles në fshatin Bilinicë .

- Kontraktor : NTP „Metaliku“ – Gjilan.

- Vlera e përgjithshme e projektit : 9,970 €

- Ka ndihmuar procesin e Universitetit – adaptimin e objektit për fillimin e vitit akademik 2013/2014

Zyra e projekteve ka pas një bashkëpunim të mirë me Komisionin Komunal për Trajtimin e Rasteve Sociale ka kryer vlersimin në teren të rasteve sociale, ka përgatitur paramasat dhe parallogarit e familjeve të indentifikuara nga komisioni për trajtimin e rasteve sociale si dhe ka ndihmuar procesin në lidhje me këto raste .

Gjatë muajit prill – maj komisioni ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e rasteve sociale dhe ka vlersuar se duhet të ndihmohen financiarisht me vleren (2500€ - 5000€) këto familje :

1. Familja Adem Byqmeti – fshati Ponesh
2. Familja Afrim Rizahu – fshati Livoq i Epërm
3. Familja Kadri Ajvazi (Fatmire Ajvazi) – fshati Livoq i Epërm
4. Familja Adem Hafizi – fshati Çelik

Po ashtu Zyra e projekteve në bashkëpunim me Ministrin e Kthimit dhe Komuniteteve ka bërë shpërndarjen e materialit për familjet te indentifikuara nga MKK nga ky procese kanë përfituar materjal ndertimore (40 thas cimet, 22 shtylla druri (krena), 944 blloka, dhe 413 copë tjegulla :

1. Familja Valdete Isufi – fshati Zheger
2. Famija Aziz Zejnullahu – fshati Zhegër
3. Florim Isufi – fshati Kmetovc

Nga ky procese kanë përfituar 27 familje prej tyre: 22 serbe, 2 rome dhe 3 shqiptare .

Gjatë muajit maj kryetari i Komunës së Gjilanit i shoqëruar edhe nga drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kanë vizituar familjen nëntë anëtarësh të Avdil Ramadanit të cilës i është ndërtuar shtëpia, në të cilën ajo tash e tutje do të jetoj, donator i ndërtimit të shtëpisë është Muharrem Isufi nga fshati Stanishor, ndërsa Komuna ka ndarë tokën për ndërtim e cila do të jetë në pronësi të Komunës së Gjilanit, zyra e projekteve ka siguruar projektin e shtëpisë ne sipërfaqe prej 75 m<sup>2</sup> .

Zyra e projekteve ne saje te bashkëpunimit te mire me komunitetin lokal, komunitetin e biznesit dhe organizatat tjera te cilat veprojne ne Komunen e Gjilanit ka përgatitur Marreveshje te Mirekuptimit bazuar në kërkesat dhe iniciativat e komunitetit lokal për participim në projekte . Komuna e Gjilanit është e dëshmuar për bashkëpunim të mirë me këshillat e fshatrave nga se roli kyç i qeveris lokale ka qen dhe është krijimi kushteve me te mira për qytetarët si dhe plotësimi efikas i nevojave të tyre .

Zyra e projekteve bene pergatitjen e marreveshjeve te mirekuptimit, ndersa te gjitha marreveshjet nenshkruhen mes paleve te interesuara per participim ne rregullimin e infrastruktures dhe kryetarit te komunes .

### *Skema e participimeve të iniciativës qytetare 2013*

*Emri i projektit : Ndërtimi i tereneve sportive dhe rrethojave në fshatin Lladovë*

---

Investitore : Komuna e Gjilanit dhe Shoqata “ 2 Prill “ ne fshatin Lladovë

---

Obligimet e Komunitetit : 14,580.00 €

---

Participimi i komunitetit : data 07/06/2013, shuma € - 7,290.00

---

Punekryeses : “ ELBAU & CONEX GROUP “ nga Gjilan

---

Vlera e kontrtates : 45,231.98 €

Fshati Lladovë kanë një fuqi të madhe të kapitalit njerëzor që jeton diasporë, me iniciativë të tyre më 9 dhjetor 2012 në Gjenevë u mbajt takimi me bashkë atdhetarë nga fshati Lladovë që jetojnë dhe punojnë në Zvicër, Gjermani, Francë dhe vende të tjera ...

Nga takimi doli i ideja e krijimit të shoqatës “2 Prilli “ Lladovë e cila u mirëprite jo vetëm nga të pranishmit por mori përmasa me te gjera nga se kësaj iniciative ju bashkuan dhe bashkëvendësit të cilët jetojnë në fshatë

*Emri i projektit : Asfaltimi i rrugës dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik rruga “Muharrem Kurteshi” Kufca e Ulët*

---

Investitore : Komuna e Gjilanit dhe Komuniteti i rrugës “ M. Kurteshi” Kufca e ulët

---

Obligimet e Komunitetit : 10,000.00 €

---

Participimi i komunitetit : data 24/07/2013, shuma € - 10,000.00

---

Punekryeses : shpk “Magjistranja” Gjilan

---

Vlera e kontrtates : 34,630.96 €

Kuvendi Komunal i Gjilanit merr për obligim te participoj – gjegjësisht te mbuloj e gjithë shume e kontraktuar të projektit mbi vlerën 10.000 € (pjesa e mbeture nga participimi)

*Emri i projektit : Furnizimi me kubza dhe rër për rrugën Lagjeja Xhelili në fshatin Përlepnice*

---

Investitore : Komuna e Gjilanit dhe Komuniteti

---

Obligimet e Komunitetit : Fuqia punëtore , mjeshtria

---

Participimi i Komunës : 250 m<sup>2</sup> kubza dhe rëra

**Ministria e Infrastrukturës (MI) :**

Gjatë muajit maj kompania nga Gjilani "Zuka Commerce" ka nisur punimet në rrugën Pogragjë – Llovcë .

Projekti ka keto karakteristika :

- Asfaltimi i rrugës Pogragjë – Llovcë – data e publikimit të tenderit nga Ministria e Infrastrukturës 07/09/2012 data e mbylljes së tenderit 17/10/2012, me datën 16/11/2012 është shaplle perfituesi i ketij projekti qe është kompania "Zuka Commerce" Gjilan, vlera e projektit është : 468,561.64 €

Gjatë muajit qershor 2013 është nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancim projekteve në mes të Ministrisë së Infrastrukturës (MI/KM nr. 1905/13) dhe Komunës së Gjilanit (02 nr.340) për financimin e projekteve " Asfaltimi i rrugëve në qytet "ku janë të përfshira këto rrugë : asfaltimi i rrugëve në Lagjen Dheu i Bardhe, Zabeli i Sahit Agës, Lagjeja numer 8 dhe Kodra e Deshmoreve, Lagjeja Arberia dhe Bregu i Djegur, Lagjeja Dardania dhe pjesa e lagjes nr.2

Projektet kanë këto karakteristika gjatë financimit :

**Vlera financimit € : 1,743.385**

- **Ministria e Infrastrukturës : 1.468,385 €**
- *Participimi : 84.23 %*
- *Viti : 2013 : 130,000 €*
- *Viti : 2014 : 1.338,385 €*
- **Komuna e Gjilanit : 275,000**
- *Participimi : 15.77 %*
- *Viti : 2013 : 75,000 €*
- *Viti : 2014 : 200,000 €*

Gjatë muajit qershor 2013 është nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancim projekteve në mes të Ministrisë së Infrastrukturës (MI/KM nr. 1904/13) dhe Komunës së Gjilanit (02 nr.339) për financimin e projekteve "Asfaltimin e rrugëve në fshatra" ku janë të përfshira këto rrugë : rruget në fshatin Zhegër, rruga Pogragjë - Bilinicë dhe rruga Lladovë - Nasalë

Projektet kanë këto karakteristika gjatë financimit :

**Vlera e financimit € : 672,575,00**

- **Ministria e Infrastrukturës : 397,575.00 €**
- *Participimi : 59.11 %*
- *Viti : 2013 : 130,000 €*
- *Viti : 2014 : 267,575 €*
- **Komuna e Gjilanit : 275,000.00 €**
- *Participimi : 40.89 %*
- *Viti : 2013 : 75,000.00€*
- *Viti : 2014 : 200,000 €*

## REKAPITULIM - BASHKËFINANCIM I PROJEKTEVE

### *Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Gjilanit :*

---

Investimet ne qytet : 1,743.385 €

---

Investimet ne fshatra : 672,575 €

---

Totali € : 2.415,960 €

---

Ministria e Infrastrukturës : 1.865,960 €

---

Komuna e Gjilanit : 550,000 €

---

Totali € : 2.415,960 €

\* Neni 3 – Komuna e Gjilanit do te udhëheqë projektin, procedurat e prokurimit dhe do të nënshkruaj kontratën .

#### **Sqarim:**

Komuna e Gjilanit i ka zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit bazuar në MiM, po ashtu ka formuar komisionet e përbashkëta të vlerësimit (Komunë – MTI), mirëpo pas publikimeve për dhënie të kontratave për të gjitha këto aktivitete kemi ankesa nga Operatorët Ekonomik në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) . Përshkak të mos funksionimit të panelit shqyrtues të OSHP-së, është pa mandat funksional asnjë lëndë nuk mund të përfundojë pa një vendim të këtij paneli .

Nga një gushti i këtij viti, bordi i OSHP-së, i njohur ndryshe edhe si gjykata e tenderëve, nuk ka shqyrtuar asnjë lëndë, pasi që kryesuesi, por edhe disa anëtar të bordit janë pa mandat. Zgjedhja e anëtarëve të bordit të OSHP-së, ka qenë e planifikuar të ndodhë në seancën fundit të Kuvendit të Kosovës (seancën e fundit të vitit 2013), por një gjë e tillë nuk ndodhi, në mungesë të kuorumit në legjislativ....

#### **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) :**

Gjatë muajit maj (19 maj 2013) personalitete nga jeta politike, publike, kulturore, ushtarake kanë marrë pjesë në përrurimin solemn të projektit : Ndërtimi i salles se edukates fizike, Çerdhes per femijë parashkollor dhe ndërrimi i mbulesës së objektit të shkollës fillore “Avdullah Tahiri”, fshati Malishevë .

Gjatë muajit qershor 2013 është nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancim projekteve në mes të Ministrisë së MAPL-ës (nr.415-781/1) dhe Komunës së Gjilanit (02 nr.384) për financimin e projektit :

Emir i projektit : Asfaltimi i rrugeve dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Shillovë (krahu i rruges 5, 7, 8)

---

Vlera e paralogaritur e projektit : 80,077.86 €

#### **Bashkefinacim i projektit :**

---

MAPL : participon në shumen e projektit : 64,062.29 €

---

Komuna e Gjilanit : participon në shumen e projektit : 16,015.57 €

---

Data e shpalljes : 24 korrik 2013 – data e mbylljes 14 gusht 2013-07-25

---

Numri i prokurimit : MAPL-13-033-5-2-1

Gjatë muajit qershor 2013 është nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancim projekteve në mes të Ministrisë së MAPL-ës (nr.415-381/1) dhe Komunës së Gjilanit (02 nr.385) për financimin e projektit :

Emir i projektit : Rregullimi i rrjetit të ujësllësit në fshatin Verbica e Kmetocit

Vlera e paralogaritur e projektit : 111,322.70 €

**Bashkefinacim i projektit :**

MAPL : participon në shumën e projektit : 80,000.00 €

Komuna e Gjilanit : participon në shumën e projektit : 31,322.70 €

Data e shpalljes : 24 korrik 2013 – data e mbylljes 15 gusht 2013-07-25

Numri i prokurimit : MAPL-13-034-5-2-1

Punëkryesë : “Berisha Company” sh.a

Vlera e kontraktuar : 89,654.25

Të gjitha procedurat e prokurimit në bazë të ligjeve në fuqi kryhen nga MAPL, zyra projekteve vetëm asiston në kompletimin e dokumentacionit , vizita në teren dhe raportimin mbi rrjedhën e projekteve .

Zyra e projekteve ka aplikuar në këtë fondë me projektin : Zhvillimi i bujqësisë përshpejton zhvillimin ekonomik dhe krijon vende të reja dhe të qëndrueshme të punës , në këtë projekt jemi partner me Komunën e Parteshit, ku kemi përfituar 49,700 € nga të cilët do të përfitojnë 11 bujqë kultivatorë, projekti implemetohet nga Drejtoria e Bujqësisë së Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Parteshit .

Zyra e projekteve gjatë vitit 2011/2012 ka aplikuar me pesë projekte në programin Masat e Eficencës së Energjisë në Shkollat projekt i financuar nga BE, ku qëllimi kryesor i projektit është që të rrisë eficiencën e energjisë në ndërtesat publike në pronësi të komunave: kjo paraqet hapin e parë dhe më të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit të Eficencës së Energjisë për Kosovën .

Nga pesë projektet që kemi aplikuar janë aprovuar tri projekte :

- shkolla e mesme “Zenel Hajdini” Gjilan
- shkolla fillore “Ramiz Cërrnica” Cerrnicë
- konvikti i Nxënësve dhe Studenteve – Gjilan

Gjatë muajit tetor 2012 është nënshkruar Marrëveshja e Mirekuptimit me :

- a) kompanin “INOCSA” e cila ka mbikëqyrjen e projekteve dhe
- b) kompanin “GE.COP.spa” e cila ka punët ndertimore

Zyra e projekteve ka marrë për obligim nga MAPL që kompanive për mbikëqyrje e projektit dhe punëve ndertimore të ofroj qasje në vende punishte dhe krijimin e letsirave për kryerjen me sukses të këtyre projekteve .

Sipas premtimit nga MAPL dhe dinamikës të aprovuar nga fondi i BE-së për Eficencë projektet do të fillojnë sipas kësaj radhitje :

- shkolla fillore “Ramiz Cërrnica” Cerrnicë - sipas palnit dinamik duhet të fillojnë me 01/06/2013
- shkolla e mesme “Zenel Hajdini” Gjilan - sipas palnit dinamik duhet të fillojnë me 06/06/2013
- konvikti i Nxënësve dhe Studenteve – Gjilan - sipas palnit dinamik duhet të fillojnë me 13/06/2013

Zyra e projekteve është angazhuar maksimalisht duke falënderuar angazhimin e Drejtorisë së Arsimit konkretisht drejtoreshave të shkollave të lartpërmendura deri në muajin gusht 2013 realizimi i këtyre projekteve nuk ka filluar

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) :**

Në vitin 2012 ka marrë për obligim të financojë realizimin e projektit të Lumit Mirusha – faza II, gjatë muajit korrik është bërë përzgjedhja e kompanisë e cila do të fillojë me realizimin e këtij projekti, kjo ministri në bashkëpunim me Komunen e Gjilanit bashkëfinancon dhe implementon projektet :

- “Rregullimi i shtratit të lumit Mirusha - faza e II” është kontraktuar me “Company Bejta Commerc” Gjilan në vlerën prej : 3.133.170,66 €

Bazuar në kontratën numër 16 - 76877 të datës 16/07/2012 e lidhur në mesë të Komunës së Gjilanit dhe N.N “Infra Plus” e cila është e kontraktuar për hartimin e projekteve në infrastrukturë (rrugë, ujësjellës dhe kanalizim) gjatë vitit 2012/2013 janë hartuar dhe janë në fazën e hartimit këto projekte :

Nr.	Emertimi dhe përshkrimi i projektit
01	Kanalizimi atmosferik në rrugën "Bajram Llovca 1 në Lagjen Arbëria" – faza parë
02	Elaborati për eksproprijimin e lumit "Mirusha"
03	Projekti kryesor për trotuari e rruges "Mulla Idrizi"
04	Kanalizimi fekal në fshatin Cërrnic
05	Kanalizimi atmosferik "ish tregu i kafshëve Lagja Arbëria-Lumi Mirusha" faza e dytë
06	Projektimi i asfaltimi të rrugëve në fshatin Zheger
07	Projekti i rruges " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu "
08	Projekti i kanalizimit fekal i rruges " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu "
09	Projekti i kanalizimit atmosferik i rruges " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu"
10	Projekti i trotuareve ne rrugen " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu"
11	Rregullimi i shtratit te lumit ne fshatin Zhegër
12	Projekti i trotuareve ne rrugen sh.f "Abaz Ajeti" deri te sh.f " Mulla Idrizi "
13	Projekti i trotuarit Llodovë –Zheger (L-4814m’)
14	Projekti i trotuarit ne rrugen Mulla Idrizi , nga Xhamia deri stacioni i autobusëve
15	Projektimi kryesor i ures per lagjen e Bilalleve L=6.70m' B=5.00 m' – Malësia e Zhegrës
16	Projektimi i mureve mbrojtese tek ura lagjen e Bilalleve – Malësia e Zhegrës
17	Projektimi kryesor i ures per lagjen e Biçakëve L=6.70m' B=5.00 m' – Malësia e Zhegrës
18	Projektimi i mureve mbrojtese tek ura lagjen e Bicakve – Malësia e Zhegrës
19	Projektimi kryesor i ures për lagjen e Limonëve L=6.70m' B=5.00 m' – Malësia e Zhegrës
20	Projektimi i mureve mbrojtese tek ura lagjen e Limonëve – Malësia e Zhegrës
21	Projektimi kryesor i ures per lagjen e Mërzishte L=10.00 m' B=5.00 m' – fshati Zhegrë
22	Projektimi i mureve mbrojtese tek ura lagjen e Mërzishte – fshati Zhegrë
23	Projektimi i rrjetit te kanalizimit /fekal/ ne pjesen rurale fshati Zhegër
24	Projektimi i rrjetit te kanalizimit /fekal/ ne pjesen rurale fshati Përlepnice
25	Rregullimi i shtratit te lumit ne fshatin Prelepnice
26	Asfaltimi i rrugëve lagja Zabeli i Sahit Agës – pjesa te shkolla
27	Asfaltimi i rrugëve "Xheladin Kurbaliu" Lagjeja Arberia
28	Asfaltimi i rrugëve ne fshatra -Fshati Velekince (pjesa e rruges se Deponis) deri Xhamia e fshatit Velekince
29	Projekti i rruges "Muharrem Kurteshi" Kufcë e Ulët
30	Projekti i kanalizimit atmosferik i rruges " Muharrem Kurteshi" Kufcë e Ulët
31	Projekti i kanalizimit atmosferik ne rrugen "15 Qershori"
32	Asfaltimi i rruges "Mulla Idrizi VII"
33	Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Kufcë e Ulët
34	Asfaltimi i rruges ne fshatin Livoq i Ulët - Lagja e Sllubicëve
35	Asfaltimi i rrugëve ne fshatra - fshati Livoq i Eperm-Pasjak ( rruga e Prishtinës -deri te lagja e Maraceve-faza e pare)
36	Asfaltimi i rrugëve ne fshatra - Fshati Bukovik - Doberqan
37	Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Cërrnic
38	Kanalizimi fekal duke filluar prej rrugës "Kumanova" deri në lumin e Livoqit të Ulët si dhe të përfshihet edhe pjesa e fundit e rrugës "Hysen Tërpeza", një rrugicë e fshatit Velekince dhe disa rrugica të cilat lidhen me rrugën "Kumanova"
39	Riprojektimi i Projektit të rruges " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu "
40	Riprojektimi i Projektit i kanalizimit fekal i rruges " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu "
41	Projekti i kanalizimit atmosferik i rruges " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu "
42	Riprojektimi i projektit te trotuareve ne rrugen " Adem Jashari dhe Zija Shemsiu "

---

Sqarim :

- Vlerat e projekteve ne kete raport jane vlera te cilat Zyra e projekteve i ka fituar përmes konkurrimit në Organizata Ndërkombetare, Qeverinë e Kosovës dhe institucione tjera buxhetore, ndërsa vlera e projekteve të kontraktuara mundë të mos përputhet sepse projektet i nështrohen një konkurrence të paraparë me Ligjin e Prokurimit Publikë të Kosovës .
- Për informata më të plota rrethë raporteve dhe te dhenave tjera të Zyrës së projekteve mundë të klikoni edhe në web faqen : <http://kk.rks-gov.net/gjilan/>, linku : projektet – investimet kapitale dhe linku : pasqyrat dhe planet komunale

Ju falenderojm për mirëkuptim,

Fadil Osmani, Menaxher i zyres së projekteve  
E-mail : [fadilosmani02@yahoo.com](mailto:fadilosmani02@yahoo.com)

Dhjetor ' 2013